



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°16/2022

Hagë, 28/04/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në gjykimin e Salih Mustafës, të premtën më 22 prill, dha dëshminë dëshmitari i trembëdhjetë i thirrur nga Mbrojtja, që dëshmoi kryesisht në seancë publike.

Gjykimi i Salih Mustafës filloi më 15 shtator 2021 me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar dhe mbrojtëses së viktimave. Zyra e Prokurorit të Specializuar thirri gjithsej 13 dëshmitarë për të dhënë dëshmi në gjykatë dhe mbylli paraqitjen e provave të veta më 4 shkurt të këtij viti.

Mbrojtja filloi me paraqitjen e provave të veta më 22 mars dhe deri tani ka thirrur trembëdhjetë dëshmitarë. Në bazë të Rregullores së Procedurës dhe Provave, si Prokurorisë edhe Mbrojtjes u është dhënë mundësia t'u drejtojnë pyetje dëshmitarëve të thirrur nga pala tjetër.

Aktualisht ka tetë viktima pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore që përfaqësohen si një grup i vetëm nga mbrojtësja e viktimave e mbështetur nga anëtarët e ekipit të saj ligjor.

Të hënën e shkuar, më 25 prill, Trupi Gjykues në çështjen *Salih Mustafa* nxori një urdhër në të cilin i kërkonte Ministrisë së Drejtësisë të paraqiste parashtrime të mëtejshme lidhur me modalitetet e mundshme që viktimat të marrin kompensim, por njëkohësisht të mbeten anonimë, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë.

Seanca vijuese në çështjen Salih Mustafa është planifikuar për më 11 maj.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, të enjten e shkuar më 21 prill, Trupi Gjykues nxori dy vendime lidhur me rishikimin e paraburgimit të secilit nga të

1





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°16/2022

Hagë, 28/04/2022

akuzuarit. Në këto vendime, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit për z. Gucati dhe vazhdimin e paraburgimit për z. Haradinaj.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

